

POLICIA , RENDI, SIGURIA DHE MARRËDHËNIET ME KOMUNITETIN



Gjetje dhe rekomandime për politika që përmirësojnë punën e Policisë së Shtetit Shqiptar në lidhje me policimin në komunitet - Prill 2014



- Të prezantojë perceptimin dhe trendin e përvojave të qytetarëve për policimin në Shqipëri
- Ofrojë MPB dhe PSH të dhëna cilësore dhe sasiore
- Mbi pikat e forta/të dobëta si ato perceptohen nga qytetaret dhe grupime të ndryshme
- Mundësitë që ka policia në terren për t'u përmirësuar dhe për t'i shërbyer sa më mirë qytetarëve të vendit.

1. **Studime dhe vlerësime ekzistuese** të kryera nga partnerë të shoqërisë civile dhe të mbështetura nga SACP përgjatë 2013-ës,
2. **Takime** me institucione publike dhe jo publike,
3. **Hulumtime të dokumenteve** strategjike zyrtarë
4. **Rezultate të studimeve sasiore** (Mars - Prill 2014) të kryera në bazë të metodologjisë së gjetjes së mostrës në mënyrë rastësore të disa kategorive të tilla të qytetarëve si:
 - viktima të krimit,
 - persona që kanë pasur përvoja me policinë e trafikut rrugor,
 - persona që kanë telefonuar tek 129 për të kërkuar ndihmën e policisë,
 - personat që kalojnë nëpër pikat e kontrollit kufitar dhe që kanë pasur ndërveprim me stafin e Policisë së Shtetit gjatë 12 muajve të fundit

5. **Kryerjen e dy studimeve cilësore** me përfaqësues të institucioneve jo qeveritare ndërkombëtare dhe kombëtare (**intervista gjysmë të strukturuar**), me grupe të rrezikuara dhe informatorë të tjerë kyç dhe të rëndësishëm (**fokus grupe**) në lidhje me ofrimin e shërbimeve të policisë dhe pikat e ndërveprimit me qytetarët. (Mars – Prill 2014)
6. Studimin cilësor me të dhëna të marra nga **përfaqësues të mediave** (e shkruar dhe televizive) në lidhje me ofrimin e shërbimeve të policisë dhe pikat e ndërveprimit me qytetarët e zakonshëm. (Intervista gjysmë të strukturuar; Mars – Prill 2014)
7. Një përmbledhje **e udhëzimeve nga praktikat më të mira ndërkombëtare** dhe intervista me përfaqësues të këtyre institucioneve në Shqipëri
8. **Eksperienca dhe mendimet e vetë ekspertëve**

- për qëllime **advokuese dhe përmirësuese**,
- si nxitje dhe stimuj për të siguruar **një platformë reflektimi** mbi situatën

- **për të kontribuar në rekomandimet për politikat në procesin e vazhdueshëm të reformimit.**

- të shihet si **kontribut shtesë** në atë çka Ministria e Punëve të Brendshme po konsultohet dhe me partnerët e tjerë të saj kryesorë
- raporti **nuk sjell përsëritje të studimeve** apo rekomandimeve ekzistuese,
- sjell një **përmbledhje** të situatave dhe perceptimeve të ndryshme mbi aspekte të rendit, të sigurisë, të performancës së policisë

- sjell një **përmbledhje** të situatave dhe perceptimeve të ndryshme mbi aspekte të rendit, të sigurisë, të performancës së policisë
- atë çka ato mund të **vlejnë për reformimin e politikave** dhe duke e ndihmuar këtë proces reformimi **duke parë nga e ardhmja**.
- raporti **nuk propozon zgjidhje të mirëfillta**
- sjell **konkluzione dhe rekomandime** mbi të cilat mund të ndërmerren **studime të tjera**
- të ngrihen **procese konsultative** për të ngritur politika dhe strategji koherente mbi reformimin e policisë së shtetit.

- Perceptimet e paraqitura në raport na sjellin **një “Fotografi” të opinionit të grupeve të anketuara** të cilat janë të vlefshme për periudhën Mars-Prill 2014.
- Duke qenë se perceptimi është një proces dinamik gjetjet e këtij raporti duhet **të lexohen në këtë kontekst** dhe jo si një vlerësim i mirëfilltë i performancës së PSH si përfaqësues **në nivel kombëtar**.
- Gjithashtu duhet patur parasysh që anketimet mbi perceptimet sjellin **opinione dhe jo fakte** bazuar në të dhëna metodike.

- Këto perceptime mbeten **të rëndësishme për të treguar se çfarë mendojnë palët e anketuara në lidhje me sigurinë dhe besimin e tyre në institucionin e PSH-së.**
- Vendosjen e **një pikënisjeje për një sërë treguesish të opinionit publik në lidhje me sigurinë dhe performancën e policisë**, të cilët mund të përdoren për të monitoruar progresin dhe arritjen e qëllimeve të MPB dhe të Policisë së Shtetit gjatë zbatimit të strategjisë së re dhe planeve të veprimit në vitet e ardhshme

- Studimi kombinon dy qasjet tradicionale studimore; **qasjen sasimore dhe qasjen cilësore.**
- Proceset hulumtuese të kryera nga dy institucionet (ICLA & IDRA) janë realizuar gjatë muajve Mars - Prill 2014.
- Studimi sjell fakte të dhënash të mbledhura nga **studime të tjera** të kryera gjatë vitit 2013-2014 nga CSO dhe të mbështetura nga SACP

Mbledhja e të dhënave u bazua në këto instrumente kryesore:

- ***Analiza e dokumenteve dhe raporteve të publikuara***
- ***Anketimi*** - Anketimet u kryen në Mars 2014 me metodën e përzgjedhjes rastësore të kampionit (anketimi me viktimë të krimit, i personave që kanë pasur përvoja me policinë e trafikut rrugor, me persona që kanë telefonuar tek 129 për të kërkuar ndihmën e policisë dhe me persona që kalojnë nëpër pikat e kontrollit kufitar.
- ***Fokus Grupe*** - shtatë fokus-grupe me 8 pjesëmarrës në secilin grup; me karakteristika të ndryshme sipas moshës, rurale dhe urbane, mësues dhe prindër, komuniteti Rom/Egjiptian.
- ***Intervista gjysmë të strukturuar*** - 64 përfaqësues të Institucioneve publike dhe jo publike dhe 28 përfaqësues të mediave

C. PSH Objektivat kryesore

Kuadri strategjik i gjetjeve dhe rekomandimeve

D. Grupet e interesit dhe përfituesit

B. Ambienti Strategjik

B1. Zhvillimi i Politikave dhe Strategjive
B2. Përmirësimi i legjislacionit

Kapacitetet e brendshme të PSH (Burimet teknike dhe njerëzore)

Shërbime komunitare (siguria, rendi, trafiku, etj)

Menaxhimi i kufirit

Lufta kundër krimit të organizuar dhe terrorizmit

A.1. Partneriteti me komunitetet dhe shoqërinë

A.2. Transformimi Institucional i PSH

D.1.PSH / Mbështetja e MPB

D.2. Ministritë e linjës dhe institucione të tjera qeveritare

D.3. Institucionet jo publike, OJF-te, partnerët kombëtarë dhe ndërkombëtarë, media dhe Shoqëria me e gjere

Hulumtimi i mangesive dhe kerkimi per permiresime te tjera ose te reja (rekomandime të politikave)

Drejt një të ardhme të një PSH të përmirësuar në shërbim të komunitetit dhe sigurisë së qytetarëve

- Gjetjet sjellin vlerësimet për punën e mirë të kryer nga Policia Shtetit,
- çështje që shihen si problematike në lidhje me sigurinë dhe qetësinë në komunitete si dhe
- fushat për përmirësim duke i parë nga e ardhmja grumbulluar në këto 4 kategori kryesore:
 1. Perceptimi,
 2. Siguria,
 3. Sistemi Organizativ dhe Performanca dhe
 4. Komunikimi me komunitetin dhe institucionet

- Raporti ICLA-s 2014 - intervista gjysmë të strukturuar me përfaqësues të institucioneve të ndryshme & Fokus-grupe, IDRA 2014
 - *Ndjesi të përgjithshme*
 - *Perceptimi mbi punën e policisë në 4 muajt e fundit (Janar – Prill 2014)*
 - *Fushat që kanë nevojë për përmirësim*
 - *Pritshmëritë*

- Anketa e policisë kufitare - IDRA (Mars 2014) - Vlerësimi i punës së policisë kufitare; Vlerësimi për policinë e shtetit

- Anketa për policinë rrugore (Mars 2014) – IDRA , Vlerësimi i punës së policisë rrugore ; Vlerësimi për policinë e shtetit

- Anketa mbi kontaktin me Policinë nëpërmjet telefonimit të (129) IDRA Mars 2014 - Vlerësimi për policinë e shtetit
- Anketa mbi ‘viktimat e krimit’ (Mars 2014) IDRA - Personat që janë anketuar në këtë studim kanë denoncuar rastet e tyre në 8 komisariate, nga të cilat 3 komisariate në Tiranë dhe 5 të tjera në rrethe jashtë Tiranës (Shkodër, Korçë, Fier, Lushnjë, Lezhë
- Studimi me Mediat (mendime mbi performancën e Policisë së Shtetit dhe marrëdhëniet me mediat) - ICLA Mars 2014

- **Ndjenja e përgjithshme –**
- 56.2% e (48) institucioneve publike janë përgjigjur se kanë marrëdhënie interaktive më Policinë e Shtetit, 19% kanë marrëdhënie mbështetëse dhe 14.5% kanë marrëdhënie përfituese.
- Marrëdhënie të mira dhe ndërvepruese ekzistojnë edhe në mes të përfaqësuesve të shoqërisë civile dhe Policisë së Shtetit, ku 57% (nga 16) prej tyre shprehen se bashkëpunimi është zhvilluar dhe është përmirësuar në fusha të ndryshme, në mënyrë të veçantë në iniciativat e përbashkëta të interesave të komunitetit apo policimit në shkollë.

- **Pyetjes si e vlerësonin rolin dhe performancën e PSH gjatë 4 muajve të fundit.**
- 46% e (48) institucioneve publike mendojnë se performanca e PSH është përmirësuar;
- 50% e (16) institucioneve jo publike janë shprehur se situata është përmirësuar krahasuar me të njëjtën periudhë një vit më parë.
- Gjithashtu, shumica e pjesëmarrësve në Fokus Grupe besojnë se situata e rendit dhe e sigurisë në Shqipëri është në përmirësim e sipër.

- **disa fusha që kanë nevojë për përmirësim dhe që duhet të merren në konsideratë nga MPB dhe PSH**
- a) rritja e profesionalizmit të PSH për çështjet që lidhen me sigurinë dhe rregullin publik;
- b) marrëdhëniet dhe qasjet etike me qytetarët;
- c) efikasiteti dhe përgjigja në kohë ndaj ngjarjeve;
- d) pavarësia politike dhe depolitizimi i strukturave;
- e) probleme që lidhen me procesin e rekrutimit;
- f) kushte më të mira të punës, pagesës dhe pajisjeve.
- Gjithashtu pjesëmarrësit kërkojnë **më shumë mbështetje nga qeveria shqiptare dhe MBP** për të mbështetur PSH me më shumë mbështetje institucionale, financiare dhe teknologji të përditësuar.

- Të gjithë të intervistuarit vënë në dukje **nevojën për një mentalitet të ndryshëm në qasjen e Policisë dhe qëndrimin e saj ndaj policimit në komunitet për t'i shërbyer dhe qenë pranë qytetarëve.**
- **Vlerësohet pozitivisht rritja e numrit të femrave në polici,**
- Në lidhje me **qasjen e PSH ndaj minoriteteve kërkohet akoma më shumë përpjekje**
- Shumë e mirë **vlerësohet puna e bërë nga PSH në shkolla**

- **Një perceptim shumë pozitiv në lidhje me punën e Policisë Kufitare**
Niveli i kënaqësisë të të intervistuarve me këto dimensione varion në shkallën 85%-89% të cilët janë të kënaqur
- **Në lidhje me Policinë Rrugore 62%** e të gjithë të anketuarve kanë vlerësuar pozitivisht (mirë ose shumë mirë) punën që po bën Policia Rrugore në 6 muajt e fundit
- **Anketimi i kryer me personat që kanë telefonuar PSH tek 129 tregoi që** në përgjithësi të anketuarit e kanë vlerësuar si të mirë punën e bërë nga Policia e Shtetit në këto 4-6 muajt e fundit në 60% të rasteve.
- **Anketimi me personat që kanë qenë viktimat të krimit tregoi që rreth 70%** e atyre që kanë qenë viktimat të krimit në muajt e fundit, janë të kënaqur me "mënyrën se si policia e ka trajtuar çështjen e tyre" dhe në lidhje me "informacionin" e dhënë nga Policia për rastin e tyre, rreth 62% u shprehën të kënaqur

- Në lidhje me **prishmëritë ndaj punës së PSH** shumica e pjesëmarrësve beson se PSH
- duhet të shtojë përpjekjet për të rritur performancën dhe besimin e publikut.
- duhet të jetë në gatishmëri për të ndihmuar qytetarët në çdo rast;
- të punojë edhe më shumë për të krijuar një imazh të mirë të forcave të policisë në sytë e publikut;
- të fokusohet në përmirësimin e trafikut rrugor;
- të luftojë krimin e organizuar;
- të luftojë korrupsionin dhe të bashkëpunojë më tepër me qytetarët.

- **Rendi dhe siguria në komunitet** (*Raporti ICLA-s 2014 - intervista gjysmë të strukturuar me përfaqësues të institucioneve të ndryshme dhe medias) Fokus-grupe, IDRA, Mars 2014 ; “Studimi mbi Matjen e Sigurisë në Komunitet”, ICLA, Nëntor 2013; “Partneritet në Kontekstin e Policimit në Komunitet”, ISPL, Shtator 2013)*
- **Siguria në trafik** (*Gjetje nga Studimi për Policinë Rrugore dhe Takimet e Fokus-Grupeve, IDRA Mars 2014, . Studimi mbi matjen e sigurisë në komunitet, ICLA & QBTL Nëntor 2013)*
- **Viktimat e krimit** (*Anketa mbi vlerësimin e policisë nga ata që kanë komunikuar me policinë në numrin 129, dhe Anketa mbi viktimat e krimit,që kanë raportuar në 8 Komisariate IDRA Mars – Prill 2014*
- **Viktimat e dhunës** - *Perceptimi i komunitetit mbi rolin e policisë në rastet e dhunës në familje (Data Centrum); Studimi për Viktimat e Krimit të Dhunës në Familje dhe Sulmeve Seksuale, Linja e Këshillimit për Gra dhe Vajza, Shtator 2013 ; Studimi mbi matjen e sigurisë në komunitet, ICLA 2013*

- ***C.1. sistemin organizativ të lidhura si me infrastrukturën ashtu dhe me kushtet e punës:***
- Ambientet dhe infrastrukturën
- Pajisjet
- Trajtimin financiar
- Zbatimin e ligjit
- Organizimi dhe Struktura e punonjësve
- ***C.2. Dhe gjetje në lidhje me performancën të lidhura me:***
- Profesionalizmin
- Shërbimin cilësor dhe të shpejtë
- Arsimin dhe kualifikimet
- Rezultatet konkrete në punë
- Kultura e Punës, një qasje e re ndaj policimit në komunitet dhe partneriteti me institucionet publike dhe jo-publike

- **Institucionet publike (48)** mendojnë se çështjet më emergjente të cilat duhen ndryshuar në mënyrë që të përmirësohet puna e Policisë së Shtetit janë:
 - *1- Profesionalizmi (12.5%)*
 - *2- Kultura, proaktiviteti, eficaenca në punë (12.5%)*
 - *3- Kushtet e Punës së policëve në terren (10%)*
 - *4- Arsimimi dhe trajnimi (6%)*
 - *5 -Bashkëpunimi institucional dhe transparenca (6%)*

- **Institucionet jo publike** kanë identifikuar të njëjtat fusha problematike që kanë nevojë për ndërhyrje urgjente në mënyrë që të përmirësohet me tej puna e Policisë së Shtetit.
- 1- Profesionalizmi (14%)
- 2- Bashkëpunimi ndër-institucional dhe transparencja (14%)
- 3- Kushtet e punës/mirëpajisja (7%)
- 4- Policimi në komunitet dhe prezenca e më shumë policëve pranë komunitetit (7%)

- Perceptimet e **përfaqësuesve të medias (28)** në lidhje me strukturën organizative të PSH-së kanë një trend pozitiv. 43% e gazetarëve e vlerësojnë të përmirësuar rolin dhe performancën e policisë në katër muajt e fundit
- Pyetjes: “ *Nëse imagjinoni një Polici të Shtetit që kryen shërbimet e saj në cilësinë më të mirë, cilat do të ishin karakteristikat kryesore që do ta përkufizonin këtë cilësi?*” - Përfaqësuesit e medias i përgjigjen:
 - Sjellja e mirë;
 - komunikimi qytetar;
 - zbardhja e ngjarjeve në kohë;
 - parandalimi i krimeve;
 - kthimi i besimit tek qytetarët

- Nga të anketuarit (*IDRA, Mars 2014 me personat që morën 129 si shërbim policor*) të pyetur se **çfarë do të sugjeronin në mënyrë që Policia e Shtetit të përmirësojë punën e saj**, të anketuarit përmendin
 - *kualifikimi/profesionalizmi* i punonjësve të policisë (28%) dhe
 - *rritja e gatishmërisë* apo prezencës së uniformave blu në komunitet (23%).
 - *trajtimi i barabartë/zbatimi i ligjit* (15%),
 - *vazhdimi i punës me ritmin e nisur* (13%),
 - *lufta ndaj kriminalitetit* (11%) dhe
 - *ruajtja e qetësisë/sigurisë publike* (4%).

Komunikimi në këtë vlerësim përfshin disa aspekte që lidhen direkt apo indirekt me performancën e punës së punonjësve të policisë:

- “Imazhi” (**perceptimi i komunitetit mbi imazhin**) që PSH gëzon në nivel komunitar;
- Shkalla e **komunikimit të brendshëm** brenda strukturës së PSH për të adresuar çështjet që lidhen me komunitetin;
- Komunikimi që PSH ka **me strukturat e tjera**, institucione, organizime komunitare dhe vetë individët për të bashkëpunuar, ndërvepruar dhe realizuar misionin e saj.
- Komunikimi në këtë kapitull shihet **si qasje dhe performancë e Policisë.**

- Reforma e PSH duhet të marrë parasysh **jo vetëm aspekte ristrukturimi organizativ por dhe ndryshime në qasje dhe në mentalitet.**
- Në këtë kuadër duhet të shihet Strategjia e Re 2014 – 2020 si dhe Plan i Ri i Veprimit. Të dyja sa më sipër duhet të jenë **të bazuara në një proces konsultativ të gjerë**
- Policia e Shtetit duhet të sjellë **jo vetëm të dhëna statistikore në lidhje me krimin por duhet të marrë në konsideratë ndjenjat dhe perceptimin e popullsisë në lidhje me qetësinë dhe rendin.**

- Policimi duhet të fokusohet në strategji komunikimi që t'i afrohet kësaj **qasjeje të re të policimit në komunitet.**
- Komunikimi strategjik duhet të përfshijë të qenit **prezent në komunitet** dhe **krijimin e një sistemi transparent për situatën** nëpërmjet mirë informimit të publikut.
- Rendi dhe siguria është diçka që shkaktohet edhe perceptohet nga vetë njerëzit. Nëpërmjet informimit të komunitetit për atë që ndodh në kohë reale dhe në mënyrë të saktë **policia bëhet më legjitime dhe profesionale** në atë që bën dhe po ashtu më e besueshme për komunitetin.

- **REKOMANDIMI 1 - Zhvillimi i një strategjie të plotë dhe të mirëfilltë për policimin në komunitet, e mbështetur nga një plan veprimi konkret që përfshin:**
- të dhëna bazë për t'u nisur si referencë për ndërhyrjet (baseline),
- synime dhe objektiva konkrete dhe të matshme
- përgjegjësi konkrete nga institucionet si në nivel qendror ashtu dhe lokal,
- afate konkrete kohore
- buxhet për të mbështetur veprimet
- mjete verifikimi dhe procese monitorimi për të treguar se si do të monitorohen dhe maten rezultatet
- Planet e veprimit në nivel qarku të jenë kapituj të planit të integruar dhe planet e veprimit të njësive dhe departamenteve të jenë të lidhura respektivisht.

- **REKOMANDIMI 2** - Zhvillimi i një strategjie të menaxhimit dhe zbatimit të ndryshimit mbi reformat në polici; për një polici me qasje të re, ku reforma është pjesë natyrale e përpjekjeve të brendshme të vetë policisë.
- **Krijimi i një sistemi komunikimi** të brendshëm me të gjitha institucionet dhe njësitë e policisë.
- **Krijimi i një sistemi vlerësimi** për matjen e nivelit të njohurive dhe formave të të sjellurit
- **Krijimi i kapaciteteve në polici me qasje policimin në komunitet**, që mund të realizohet përmes:
 - përfshirjes së aftësive për policimin në komunitet në kriteret e rekrutimit të punonjësve të rinj
 - ngritjes së një sistemi trajnimi të fokusuar ndaj policimit në komunitet
 - përfshirjes së kriterëve të policimit në komunitet në sistemin e vlerësimit, matjen e performancës (në nivel individual dhe njësie) dhe në sistemin e shpërblimeve individuale.

- **REKOMANDIMI III** - Zbatimi i një strategjie dhe plan veprimi për përfshirjen dhe bashkëveprimin e komunitetit si pjesëmarrës, kontribues dhe përfitues i Policimit në komunitet.

Për këtë, në planin e veprimit duhet të përfshihen masa të tilla si:

- Konsultimi me komunitetin nëpërmjet strukturave të ndryshme ekzistuese
- Socializimi dhe komunikimi i konceptit të policimit në komunitet në nivel lokal/komunitar
- Policimi në komunitet si një model pune i punonjësve të policisë.
- Përmirësimi i Partneritetit me Publikun e Gjerë..

- **REKOMANDIMI IV** - Kryerja dhe zbatimi i një sistemi të detajuar (periodik) të matjes së performancës dhe perceptimeve mbi performancën e policisë nga forume të ndryshme të komunitetit dhe shoqërisë civile (përfshirë mediat).
- ekzistojnë një sërë studimesh të kryera nga OSHC-të me të cilat PSH mund **të ngrejë një sistem të dhënash bazë, që të mund të përdoren si sistem referimi** nga PSH për matjen e opinionit publik të grupimeve të ndryshme shoqërore si dhe perceptimet e tyre në lidhje performancën e Policisë.
- **Të dhënat duhet të jenë të disagreguara në sa më shumë detaje** për të adresuar çështje që vijnë nga grupime të ndryshme demografike si gjinia, mosha, rajoni, niveli i arsimimit, etnia, etj.

- **REKOMANDIMI V** - Formulimi dhe zbatimi i një strategjie të re komunikimi
- Forma të reja të komunikimit si me komunitetin e gjerë ashtu dhe me palët e tjera të shoqërisë me anë të një qasjeje të re komunikimi.
- Hartimi dhe miratimi i një manuali për prezantimin në media të policimit në komunitet.
- Përmirësimi i imazhit publik të policisë duke përforcuar marrëdhëniet me komunitetin
- Rritja e ndërgjegjësimit për rolin real të policisë dhe efikasitetin e saj aktual përmes:
 - Rritjes së pranisë dhe paraqitjes së aktivitetit të policisë në media (televizione dhe programe radiofonike, artikuj në gazeta e revista).
 - Zhvillimit të një lidhjeje (link) brenda faqes së internetit të Policisë së Shtetit që të ofrojë informacion konkret, të detajuar dhe praktik
 - • Organizimit të aktiviteteve brenda ambienteve të komisariateve të policisë
- Me rëndësi është që **rekomandimet e këtyre studimeve të mblidhen në një dokument të integruar dhe të kthehen në një dokument strategjik komunikimi të zbatueshëm me masa dhe plane konkrete.**

- **REKOMANDIMI VI** - Përmirësimi i bashkëpunimit dhe bashkërendimit të punëve ndërinstitucionale.
- rekomandohen 2 (dy) linja veprimi:
- Të nxitet interesi i partnerëve shtetërorë për forma të reja bashkëpunimi me policinë;
- Të formalizohet ligjërisht detyrimi i partnerëve shtetërorë për t'u përfshirë aktivisht në proceset e rëndësishme të planifikimit dhe monitorimit të policimit në komunitet.
- Gjithashtu rekomandohet ngritja e një komiteti koordinues për policimin në komunitet
- Një formë tjetër bashkëpunimi mund të konsiderohet dhe organizimi në mënyrë sistematike të trajnimeve të përbashkëta me punonjës të institucioneve të ndryshme, që merren me çështje ndërinstitucionale.

- **Rekomandimi VII** - Për përmirësimin e bashkëpunimit mes policisë dhe partnerëve të shoqërisë civile:
- Policia e Shtetit duhet të jetë aktive në kërkimin dhe zbatimin e formave praktike të ndërveprimit me OSHC-të;
- Policia e Shtetit duhet të krijojë sisteme të ndryshme si psh. marrëveshje dhe memorandume bashkëpunimi të lidhura me detyra konkrete dhe të krijojë sisteme të matjes së performancës dhe raportimit periodik;
- Çdo drejtori e policisë në qark duhet të ndërtojë një *datbazë* të plotë me emrat, adresat dhe pikat e kontaktit të organizatave jo qeveritare aktive. Konsultimi i këtyre subjekteve të bëhet sipas një kalendari të mirëpërcaktuar dhe në mënyrë publike; si dhe të zhvillojë këshillime të thjeshta dhe periodike me përfaqësues të biznesit në qark;
- Policia duhet të raportojë periodikisht dhe publikisht për ecurinë e saj në zbatimin e memorandumeve.

- **REKOMANDIMI VIII** - Për përmirësimin e kushteve të punës së policisë dhe infrastrukturës së saj.
- Duke qenë se ekzistojnë dokumente të tjerë strategjik me rekomandime specifike të disponueshme nga MPB dhe PSH nuk duam të sjellim ndonjë rekomandim specifik në këtë kuadër.
- Në këtë kuadër do të rekomandonim që MPB dhe Policia të **përfshinte në strategjinë e re dhe plan veprimin për policimin në komunitet në mënyrë të integruar masat, progresin dhe arritjet në lidhje me përmirësimin e ambienteve dhe infrastrukturës; pajisjet; trajtimin financiar dhe masat për riorganizimin dhe funksionimin e strukturave të PSH.**

■ FALENDERIME